

## TË RINJTË NË INTEGRIME (V)

# Mali i Zi në rrugën drejtë anëtarësimit në NATO

Në bazë të Deklaratës për pavarësi, të miratuar në Kuvendin e Malit të Zi, më 03 qershor të vitit 2006, Mali i Zi është përcaktuar qartë për integritet euroatlantike, të cilat paraqesin një nga prioritetet e aktiviteteve të Qeverisë. Në rrugën drejt anëtarësimit fuqiptot në NATO, Malin e Zi e presin disa aktivitete të cilat duhet ndërmarrë në planin e brendshëm, të reformës së tërësishme të sistemit të sigurisë dhe para së gjithash sistemit të mbrojtjes. Drejt këtij qëllimi Malin e Zi e presin dy procese: *Partneriteti për paqe* dhe *Plani aksional për anëtarësim*. Të dy proceset kanë për qëllim arritjen e nivelit të nevojshëm të interoperabilitetit (harmonizimi i ndërsjellët) me anëtarët e NATO-s.

## Datat e rëndësishme në marrëdhëniet e deritanishme të Malit të Zi dhe NATO-s:

**Më 29 nëntor 2006** - Samiti i NATO-s në Rigë: Mali i Zi ftohet për anëtarësim në programin "Partneritetin për Paqe";

**Më 3 dhjetor 2006** - Mali i Zi fiton statusin e vëzhguesit në Kartën e Adriatikut, e cila në bazë të iniciativës së samitit të NATO-s në Pragë (2002), është nënshkruar në mes të Shqipërisë, Kroacisë, Maqedonisë dhe SHBA (Tiranë, 2 maj 2003);

**Më 14 dhjetor 2006** - Nënshkruhet Dokumenti kornizë i Partneritetit për paqe (PP);

**Më 14 qershor 2007** - Qeveria ka miratuar Strategjinë e mbrojtjes;

**Më 11 tetor 2007** - Qeveria ka miratuar Strategjinë komunikuese mbi integritet euroatlantike të Malit të Zi;

**Janar 2008** - Plani Individual i Partneritetit (IPP) të Malit të Zi zyrtarisht dhe pa vërejtje është pranuar nga 26 vende anëtare të NATO-s;

**Më 4 shkurt 2008** - NATO ka lejuar fillimin e hartimit të Planit Veprues Individual të Partneritetit (IPAP).

**Shkurt 2008** - Kuvendi i Malit të Zi ka miratuar Ligjin mbi sekretin e të dhënave, vendim ky i rëndësishëm për fitimin e certifikatës, në mënyrë që Mali i Zi të ketë qasje në të dhënat e NATO-s, të cilat kanë një shkallë të caktuar fshehtësie;

**Më 3 prill 2008** - Në Samitin e NATO-s në Bukuresht, Mali i Zi zyrtarisht është ftuar të fillojë procesin e Dialogut të intensifikuar me NATO-n;

**Më 12 qershor 2008** - Këshilli i PP-së e ka miratuar Dokumentin iniciues për diskutim, për Dialogun e intensifikuar;

**Më 24 qershor 2008** - Mbahet mbledhja për Dialog të intensifikuar të përfaqësuesve të Malit të Zi dhe NATO-s, në selinë e aleancës në Bruksel;

**Më 3 korrik 2008** - Qeveria ka miratuar Informatën mbi përparimin e Malit të Zi në Partneritet për paqe;

**Më 5 nëntor 2008** - I dërgohet letër Sekretarit të përgjithshëm të NATO-s për hyrje të Malit të Zi në Planin Veprues për Anëtarësim - MAP, në samitin e radhës të NATO-s;

**Më 4 dhjetor 2008** - Mali i Zi ka zyrtarizuar statusin në Kartën e Adriatikut, në mbledhjen ministrore në Helsinki;

**Më 18 dhjetor 2008** - Qeveria ka miratuar Ligjin për ushtrinë, duke e harmonizuar atë me Kushtetutën dhe Ligjin për mbrojtjen;

**Prill 2009** - Në Deklaratën përfundimtare nga Samiti i NATO-s në Strasburg dhe Këln, Malit të Zi i është dhënë përkrahje e fuqishme dhe premtimi se aleatet së shpejti do të shqyrtojnë kërkesën e tij për MAP;



26 – 27 nëntor 2009 – Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Anders Fog Rasmussen, ka vizituar Malin e Zi.

Më 4 dhjetor 2009 – Në mbledhjen e ministrave të punëve të jashtme të shteteve anëtare të Aleancës, e cila është mbajtur në Bruksel, më 3 dhe 4 dhjetor 2009, Malit të Zi i është dërguar ftesë për Planin veprues të anëtarësimit (MAP);

Qershor 2010 – Qeveria e Malit të Zi ka miratuar Analizën strategjike të mbrojtjes, dokument kyç në sektorin e mbrojtjes, i cili është harmonizuar me pakon e re të qëllimeve të Partneritetit;

Më 16 shtator 2010 – Qeveria e Malit të Zi ka miratuar Programin e parë vjetor nacional (ANP), në kuadër të ciklit të parë të Planit veprues për anëtarësim (MAP);

Më 28 tetor 2010 – Në Bruksel është prezantuar Programi i parë vjetor nacional në mbledhjen e Këshillit Veriatlantik (NAC), me ç'gjë Mali i Zi e filloi ciklin e parë të implementimit të Planit veprues për anëtarësim (MAP);

Më 18 tetor 2011 – Në selinë e NATO-s në Bruksel, Mali i Zi prezantoi Planin e dytë vjetor (ANP), në kuadër të Planit veprues për anëtarësim (MAP).

Hapat e Malit të Zi në procesin euroatlantik u vlerësuan shumë pozitivisht dhe u theksua se rekomandimi i Komisionit evropian për hapjen e bisedimeve me Malin e Zi, dukshëm do të ndikojë edhe në përshejtimin e anëtarësimit në Aleancën e NATO-s.



QEVERIA e MALIT TË ZI  
Ekipi bashkërendues për implementimin e  
Strategjisë komunikuese  
për integrimet euro-atlantike



**KOHA**  
Javore

Shkrimet në kuadër të ciklit INTEGRIME që u botuan në pesë numra të gazetës «Koha Javore», janë përgatitur dhe përshtatur për botim nga organizata e shoqërisë civile HORIZONTI i RI - Ulqin.

Këto shkrime u realizuan në kuadër të projektit «Të rinjtë në integrimet» i cili është vazhdimësi e aktiviteteve të filluar vite më parë e të cilët, para së gjithash, iu dedikohen të rinjve në Ulqin dhe më gjerë.

Ashtu sikur se rritet dinamika e procesit të integritimeve të Malit të Zi në BE dhe në NATO, në të njëjtën mënyrë shtohet edhe nevoja e përgatitjes dhe e përfshirjes sa më të madhe të të rinjve në këto procese. Informatat që marrin të rinjtë për këtë procese janë mjaft të kufizuara, sidomos në hapësirat ku jetojnë shqiptarët në Mal të Zi. Kjo ndodhë për arsye se informacionet e nevojshme për proceset aktuale integruese, nuk përkthehen ose nuk përcillen siç duhet tek të rinjtë shqiptarë. Nisur nga ky aspekt, OJQ «Horizonti i Ri» në bashkëpunim me Ekipin bashkërendues për implementimin e Strategjisë komunikuese për integrimet euro-atlantike, në Qeverinë e Malit të Zi dhe të mbështur nga KOHA JAVORE, realizuan aktivitete për edukimin dhe informimin e të rinjve për proceset e integritimeve evropiane dhe euro-atlantike.